

## Faqe përkujtuese SGGG mbi rrezikun e mpiksjes (koagulimit) nga mjetet mbrojtëse hormonale kunder shtatezenis (për shërbim të pacientëve)

### 1. Fillimi i parandalimit të shtatzënisë me mjete mbrojtëse hormonale

Para se të filloni përdorimin e mjeteve hormonale për parandalimin e shtatzënisë, do të duhej që mjeku ose mjekja juaj të bëjë një anamnezë të kujdesshme tuajën dhe të familjes (të dhënat mbi sëmundjet tuaja dhe të familjarëve) si dhe të bëjë një kontrollim rrënjësor të përgjithshëm dhe, sipas rregullit, edhe gjinekologjik (Përrjashtim: femrat e reja që e përdorin për herë të parë). Shtatzënia përjashtohet. Pirja e duhanit e shton dukshëm rrezikun e një „tablete“. Gjatë zbatimit të mjeteve për parandalimin e shtatzënisë rekomandohen kontrollime mjekësore në distanca kohore njëvjeçare, ndërsa në rastet me faktorë rreziku shtesë, në periudha gjysmë viti.

### 2. Veprimet anësore të një parandalimi të shtatzënisë me mjete të kombinuara hormonale të mbrojtjes, në veçanti ndikimi në kuagulimin (mpiksjen) e gjakut, rreziku për sëmundjet e enve te gjakut.

Te gratë që përdorin mjete hormonale për parandalimin e shtatzënisë („tabletat“ klasike, flasterët, unazën), pra ndonjë mjet mbrojtës që përmban një Oestrogen dhe një Gestagen, ekziston një rrezikshmëri më e shtuar për paraqitjen e mpiksjes në vena dhe arterie (sëmundje tromboembolike venoze dhe arteriale), e cila mund të shkaktojë dëmtime relativisht të rënda shëndetësore. Rreziku për mpiksjen është më i lartë në vitin e parë të përdorimit. Mpiksja mund të shkaktojë trombozë të venave ose emboli të mushkërive, ndërsa në arterie mund të shkaktojë edhe goditje në tru ose infarkt. Rreziku i këtyre trombozave ose embolive ekziston në të gjitha mjetet e kombinuara hormonale të parandalimit të shtatzënisë (tableta, flasterë, unaza), por është zakonisht dukshëm më i vogël se sa rreziku gjatë shtatzënisë.

Është raportuar rreth rasteve të rralla të mpiksjes në sy (trombozat e retinës) ose në organe tjera. Mirëpo nuk ka mundur të dëshmohet ndonjë varshmëri e këtyre paraqitjeve me përdorimin oral të mjeteve kontraceptive.

Rreziku i mpiksjes (koagulimit) së gjakut në vena dhe arterie ose i paraqitjeve tjera të rënda anësore shtohet në rastet e:

- Moshimit
- Konsumimit të duhanit; rreziku për çrregullime të qarkullimit të gjakut në zemër ose në tru (infarkti/goditja në tru) rritet edhe më shumë te gratë që pinë shumë duhan me shtyrjen e tyre në moshë. Për këtë arsye ju nuk do të duhej të konsumoni duhan, sidomos nëse jeni në moshën mbi 35 vjeçare. Njoftojeni patjetër mjekun/mjekën mbi duhanpirjen tuaj.
- Paraqitjes së mëhershme të trombozës së venave, embolisë së mushkërive, infarktit ose goditjes së tru te ndonjëri nga anëtarët e familjes (motra, vëllezër, prindër).
- Çrregullimeve me mpiksje të gjakut
- Mbipeshës së theksuar (mjeku/mjekja juaj do të ju informojë lidhur me këtë)
- Çrregullimeve të metabolizmit të yndyrave në gjak (metabolizmit të lipoideve)
- Sëmundjeve të sheqerit
- Tensionit të lartë të gjakut (në veçanti te tensioni i lartë që konstatohet vështirë)
- Migrenës
- Disa sëmundjeve të zemrës
- Qëndrimin shtrirë ose lirisë së kufizuar të lëvizjes pas ndonjë aksidenti ose operacioni
- Thyerjes së këmbës ose ndërhyrjes në këmbë
- Udhëtimeve të gjata me aeroplan ose me autobus
- Sëmundjeve të mëlçisë ose të fshikëzës së tëmthit

### 3. Në rastet paraqitjes së mpiksjes ose të ankesave që po i radhisim në vazhdim, ju duhet ta ndërpritni (përdorimin e kontraceptivëve) dhe të konsultoni mjekun/mjekën tuaj

- Migrena (para së gjithash me „aurë“) ose dhembjet veçanërisht të forta të kokës, çfarë ju nuk keni
- pasur më parë ose nuk i keni pasur aq të shpeshta, të rregullta
- Çrregullimet e befasishme në të pamur, të dëgjuar e në të folur ose çrregullime tjera të perceptimit
- të realitetit
- Dhembje të pasqarueshme dhe të njëanshme të këmbëve, me ose pa u ajur
- Probleme të përnjëhershme të frymëmarrjes ose paraqitje e befasishme e kollitjes pa ndonjë
- shkak të qartë
- Dhembje të befasishme të fuqishme në kraharor me ose pa reflektim në krahun e majtë
- Paraqitje e përnjëhershme e marramendjes, ndjenjës së ligështimit, çrregullimit të emocioneve ose çrregullime koordinuese
- Kolaps me ose pa ngërçe

**Komisioni për sigurimin e cilësisë** (President Prof. Dr. Daniel Surbek)

**Grupi i punës i endokrinologjisë gjinekologjike dhe të mjekësisë reproduktive të SGGG (AGER/GTER)**

(G.S. Merki-Feld, J. Bitzer, J. Seydoux, M. Birkhäuser)

Data: 7 qershor 2010